

## Vendimi mbi atë që s'është i aftë të shohë urtësi mbrapa vendimeve të Allahut dhe e mendon veten më të dijshtëm e më të urtë se Allahu

Islamqa.info

**Pyetje:** E di se Allahu thotë në Kuran se, në Ditën e Gjykimit, askush s'do t'i bëjë vërejtje drejtësisë së Tij, por, nëse në këtë jetë unë nuk mund të kuptojë ndonjë nga vendimet e Allahut dhe s'mund të mos mendojë se Ai është i padrejtë, a përbën kjo shirk? Pra, a është shirk nëse mendoj se Zoti është i padrejtë dhe unë e di më mirë?

### Përgjigje:

Lavdi Allahut.

Besimi në Allahun ﷻ nuk kufizohet në besimin se Ai ekziston. Është po aq e rëndësishme të besosh se Ai ka cilësi të përsosura dhe epërsia e Tij është përtej të kuptuarit të njerëzve. Pikërisht kësaj i referohet në Kuran si “përshkrimi më i lartë / *el-methel el-a'laa*”. Allahu ﷻ thotë:

“Ai është i Cili shpiku krijimin, pastaj e përsërit (pasi të asgjësohet). Kjo është lehtë për Të. Për Të është përshkrimi më i lartë (asgjë nuk krahasohet me Të) në qiej a në tokë. Ai është Pushtetploti, i Urti.” (er-Rum, 27)

Ibn el-Kajjim i bëri një koment të shkëlqyer shprehjes “përshkrimi më i lartë” në punimin *es-Sewaa'ik el-Murseleh fir-Radd ala el-Xhehmijeh wel-Mu'atilah* (2/430):

“Nëse dëshiron ta kuptosh më mirë këtë ‘përshkrim më të lartë’, llogarit në mendjen tënde fuqinë e tërë krijesave dhe përfytyro tërë këtë të mbledhur në një individ, pastaj përfytyro të gjithë atë të kenë fuqinë e atij individ. Po krahasove fuqinë e këtij individ me fuqinë e Allahut ﷻ, do të shohësh se ky krahasim është i pavlefshëm, mu siç është i pavlefshëm krahasimi mes fuqisë së mushkonjës dhe fuqisë së luanit.

Përfytyro dijen e tërë njerëzimit të mbledhur në një individ, pastaj përfytyro ata të kenë dijen e atij individ; dija e të gjithë atyre, në krahasim me dijen e Allahut, do të ishte sikurse çukitja e shpendit në det.

Po ashtu s'do të mund të bësh krahasim mes urtësisë së tërë njerëzimit dhe urtësisë së Allahut ﷻ, nëse llogarit në këtë mënyrë.

Nëse llogarit tërë bukurinë në ekzistencë dhe ta përfytyrosh të mbledhur në një individ, pastaj t'i përfytyrosh të gjithë njerëzit të bukur si ky individ, në krahasim me bukurinë e Allahut ﷻ, kjo do të ishte si drita e një llambe të dobët karshi dritës së diellit. Allahu ﷻ thekson këtë ide, kur thotë:

'Sikur të gjithë drunjtë në tokë të ishin lapsa dhe oqeanit t'i shtoheshin edhe shtatë oqeane, fjalët e Allahut nuk do të soseshin. Vërtet Allahu është Pushtetploti, i Urti.' (Lukman, 27)

Pra, përfytyro oqeanet e botës të jenë bojë shkrimi dhe kësaj t'i shtoheshin edhe shtatë herë aq më shumë dhe krejt kjo të shteret pa u harxhuar fjalët e Allahut ﷻ. Po ashtu përfytyro që tërë drunjtë e tokës, nga fillimi i krijimit të tokës deri në fundin e saj, të bëhen lapsa dhe të gjithë të harxhohen pa u harxhuar fjalët e Allahut."

Kur ta kuptosh këtë, do të shohësh se vendimet e Allahut ﷻ dalin nga dija, drejtësia, urtësia, dhe mirësia. Allahu ﷻ thotë:

"Fjalët e Zoti tënd janë plot vërtetësi dhe drejtësi. Askush s'mund t'i ndryshojë fjalët e Tij. Ai dëgjon gjithçka, sheh gjithçka." (el-En'am, 115)

Allahu ﷻ thotë, kur flet për robin dhe pejgamberin Hud:

"I mbështetem Allahut, Zotit tim dhe Zotit tuaj. S'ka krijesë të gjallë që Ai s'e ka nën kontroll. Vërtet Zoti im është në rrugën e drejtë (në të vërtetën)." (Hud, 56)

Ibn el-Kajjim tha në *Medarixh es-Saalikin Bejne Menaazil Ijjaake Na'budu ue Ijjaake Nesta'in* (1/44):

"Ajeti në suren Hud s'mund të interpretohet ndryshe përveçse Allahu ﷻ është në rrugën e drejtë dhe Ai ﷻ është më i denji për të qenë në rrugën e drejtë, meqë tërë e folmja e Tij është vërtetësi, drejtësi, udhëzim dhe urtësi: 'Fjalët e Zoti tënd janë plot vërtetësi dhe drejtësi.' Dhe të gjitha veprat e Tij janë të dobishme, të urta, të mëshirshme, të drejta, të mira. E keqja s'mund të jetë pjesë e veprave a fjalëve të Atij që është në rrugën e drejtë; e keqja mund të jetë vetëm pjesë e fjalëve dhe veprave të atij që largohet nga rruga."

Allahu ﷻ na thotë se vendimet e Tij bazohen në të vërtetën dhe në drejtësi, ndërsa vendimet e të tjerëve bazohen në padituri. Sill ndër mend tash çfarë përmbajnë fjalët e paditurisë nga keqbërja, errësira, padrejtësia, çorientimi. Allahu ﷻ thotë:

"Gjykimin e kohës së injorancës e duan ata? Po kush gjykon më mirë sesa Allahu për një popull që besojnë bindshëm." (el-Ma'ideh, 50)

Ibn el-Kajjim tha në *el-Sewaa'ik el-Murseleh* (3/1046):

“Allahu ﷻ tha se çdo vendim që bie në kundërshtim me vendimin e Tij, të cilin Ai ia ka shpallur të Dërguarit të Tij, del nga tekat dhe nga dëshirat e nuk është një vendim që del nga urtësia; pra është një vendim i dalë nga padituria, jo një vendim i dalë nga dija e udhëzimi. Allahu ﷻ thotë:

‘Gjyko (O Muhamed) ata me atë që shpalli Allahu e mos ndiq tekat e tyre, dhe ruhu të të mos largojnë nga ajo që zbriti Allahu. Nëse ata kthejnë shpinën, atëherë dije se Allahu synon t’i ndëshkojë për disa gjynahe që kanë bërë. Vërtet shumica e njerëzve janë të pabindur ndaj Allahut. Gjykimin e kohës së injorancës e duan ata? Po kush gjykon më mirë sesa Allahu për një popull që besojnë bindshëm.’ (el-Ma’ideh, 49-50)

Kështu, Allahu ﷻ na tregon se s’ka gjë përtej asaj çfarë Ai shpalli, përveç ndjekjes së tekave e dëshirave që shmangin njerëzit nga shtegu i Tij; dhe s’ka gjë përtej vendimeve të Tij, përveç vendimeve të injorancës.

Të gjitha pikëpamjet dhe idetë që bien në kundërshtim me atë çfarë solli i Dërguari i Allahut ﷺ, bazohen në teka, në dëshira e në vendime të injorancës, edhe nëse ata që i propagandojnë i përshkruajnë si fakte racionale dhe prova të padiskutueshme, gjë që është e njëjtë me përshkrimin që idhujtarët u bëjnë idhujve të tyre (duke i përshkruar si zota) dhe me përshkrimin që hipokritët u bëjnë përpjekjeve të veta për të përhapur çrregullim në tokë dhe për t’i larguar njerëzit nga besimi si përpjekje për të përhapur drejtësi dhe për të bërë atë që duhet.”

Tek e fundit, a mendon ti, o rob i parëndësishëm i Allahut, si një krijesë e dobët që je, se po di më mirë se Allahu ﷻ dhe, me mendjen tënde të dobët, po kupton më mirë atë që Njohësi i të fshehtës s’po e kupton?! Lavdi Allahut të lartësuar! Sa e madhe është fuqia e Tij dhe sa i përmbajtur që është Ai! Ti, vërtet, ke sjell (thënë) një gjë të hatashme, prej së cilës qiejt e toka gati pëlcitën! Nga je duke shkuar me tërë këto ide të gabuara? Në cilin shteg të humbjes po të udhëheqë shejtani i mallkuar? Dëgjo çfarë thonë të urtët dhe filozofët:

“Dija i përket më të Mëshirshmit – lavdi i qoftë Atij – dhe çdokush tjetër përmbytet në mosdije. Çfarë ka të bëjë me dijen qenia e njerëzore që u krijua nga pluhuri? Bile ai mundohet fort të kuptojë se vetë nuk di gjë.”

Filozofi i madh Ebul-Welid ibn Rushd (v.595H) tha:

“Gjëja më e vërtetë që thonë filozofët, është se arsyeja ka një kufi ku ndalet dhe s’mund të shkojë më tej.” (*Tehaafut et-Tahaafut*, 2/534)

Allahu ﷻ, me urtësinë e tij sublime, mund ta sprovtojë robin e Vet duke e bërë që të mos shohë urtësinë mbrapa një urdhri a vendimi, në mënyrë që ta sprovtojë besimin e robit dhe të shihet nëse ai do t'i nënshtrohet vendimit të Zotit apo do t'i bëjë vërejtje e të marrë një qëndrim arrogant ndaj Tij. Personi me të menduar të matur, që është një besimtar i vërtetë, i nënshtrohet vendimit të Zotit, edhe nëse urtësia mbrapa një ndodhie mbetet e fshehtë për të, pastaj lut Zotin e vet duke i kërkuar ta udhëzojë dhe t'ia mësojë atë që është e fshehtë për të.

Meqenëse Allahu ﷻ e di se njerëzit s'janë në gjendje të kuptojnë krejtësisht urtësinë e Tij, fuqinë e Tij dhe kontrollin e Tij mbi çështjet e krijimit, Ai nuk u la shpresë për të bërë garë me Të në sundimin e Tij apo që ta marrin në pyetje për çfarëdo që Ai bën. Kjo sepse është Zoti i tyre Ai që do t'i marrë në pyetje ata dhe do t'i gjykojë. Sa u përket robërve të Tij, ata s'janë asgjë më shumë sesa robër. Allahu ﷻ thotë:

“Zoti yt krijon çfarë të dojë. Ata s'kanë mundësi të zgjedhin (në ndonjë çështje). Ai është i patëmëta dhe i lartësuar nga çdo gjë që i shoqërojnë (si ortakë). Zoti yt e di çfarë fshehin gjokset (zemrat) e tyre dhe çfarë shfaqin. Ai është Allahu. Përveç Tij, s'ka të denjë për t'u adhuruar. Lavdi i qoftë Atij në të parën (në këtë botë) dhe në të fundit (në botën tjetër). Atij i takon të gjykojë dhe Atij do t'i kthehemi.” (el-Kasas, 68-70)

“E Tij është çdo gjë në qiej dhe në tokë. Ata që janë pranë Tij (engjëjt), i bëjnë lavde dhe asnjëherë nuk plogështohen. A mos morën ata zota nga tokë (idhuj) që ngjallin të vdekurit? Po të kishte në to (në qiej e në tokë) Zota të tjerë veç Allahut, ato do të shkatërroheshin. Lavdi Allahut, Zotit të Arshit, për atë çfarë i veshin ata! Ai s'do të pyetet për atë çfarë bën, por ata do të pyeten. A mos morën të tjerë për zota në vend të Tijin? Thuaj: ‘Sillni provat tuaja.’ Ky Kuran është kujtues për ata që janë me mua dhe kujtues për ata para meje, megjithatë shumica e tyre nuk dinë të Vërtetën, andaj dhe kundërshtojnë.” (el-Enbijaa, 19-24)

Shejhul-Islam ibn Tejmije tha:

“Allahu nuk pyetet për atë çfarë bën jo vetëm për shkak të nënshtimit që Ai i bën krijimit dhe për shkak të fuqisë së Tij, por për shkak të urtësisë së përsosur, mëshirës së përsosur, dhe drejtësisë së përsosur që Ai ka.”  
(*Mexhmu el-Fetaawa*, 8/511)

Allahu ﷻ nuk emëroi ndonjë ortak në krijimin që bëri; Ai është krijuesi i vetëm. Askush nuk ishte aty për ta dëshmuar (krijimin) apo për ta mësuar, lëre më që t'i ketë ndihmuar apo të ketë qenë ortak i Tij në këtë:

“Unë (Allahu) nuk i mora ata (Iblisin dhe pasardhësit e tij) për të dëshmuar krijimin e qiejve dhe tokës dhe as krijimin e vetë atyre. Dhe Unë nuk mora çorientuesit për ndihmës.” (el-Kehf, 51)

E, çfarë të thuhet për një çështje natyra e së cilës është e panjohur për ty? Ti nuk ishe i pranishëm atëherë kur ajo u krijua. Ti nuk di gjë për origjinën e saj dhe për zhvillimin e mëpasshëm. Megjithatë, ti konteston dijen e Tij rreth saj:

“Si të mos dijë Ai që krijoi ndërsa Ai është i Mirësjellshmi (ndaj robërve), i Mirinformuari (për çdo gjë).” (el-Mulk, 14)

Ti je i padijshëm për pozitën që ke, ke tejkaluar kufijtë e tu, i kë bërë zullum vetvetes, s'i ke bërë vetes kurrfarë favorimi me këtë ndërsa i je ekspozuar një dëmi të madh, që ta sjellë shkatërrimin.

Shkaku kryesor i gabimit tënd është fakti se ti nuk bën dallim mes asaj që është e pamundshme logjikisht dhe asaj që është e pakapshme logjikisht.

Ajo që fsheh urtësi në vetvete apo është e pamundshme të kuptohet, hyn në atë që është e pakapshme nga mendja e njeriut. Kjo i bën njerëzit të teorizojnë rreth urtësisë mbrapa ndodhive. Në fe, në shenjë sprove, mund të shohësh gjëra që janë përtej të kuptuarit. Megjithatë, s'ka gjë në fe që është e pavend sipas arsyes. Allahu ﷻ nuk përfshiu asnjëherë diçka të këfillë në fenë e Tij dhe as në krijimin dhe urdhrin e Tij. Dështimi për të bërë dallimin mes këtyre dyjave, është shkaku i devijimit të shumë njerëzve. Shejhul-Islam ibn Tejmije tha:

“Pa dyshim, të Dërguarit u thonë njerëzve gjëra që aftësia mendore e tyre s'mund t'i kapë, megjithatë ata nuk u thonë diçka që është e pamundshme logjikisht. Me fjalë të tjera, të Dërguarit u thonë njerëzve atë që është e pakapshme nga mendja njerëzore, por jo dhe e pamundshme. Kështu, kushdo që do të kuptojë me arsyen e vet atë çfarë thanë të Dërguarit, është sikurse ata për të cilët Allahu ﷻ thotë:

‘Kur atyre u vjen një shenjë (nga Allahu), thonë: ‘Nuk do të besojmë, derisa të pranojmë atë çfarë pranuan të Dërguarit e Allahut.’ (Por) Allahu e di më së miri ku ta vejë mesazhin e vet.’ (el-En'am, 124)

‘Madje, secili prej tyre dëshiron t'i jepen faqe të shtrira (t'u vijë konfirmimi me shkrim secilit se Islami është feja e vërtetë)’ (el-Muddethir, 52)” (*Dar Te'arud el-Akl wen-Nakl, 7/327*)

Ai po ashtu tha:

“Nuk mund të ndodhë që të Dërguarit të thonë diçka që s'është e mundshme sipas mendjes së shëndoshë apo të menduarit racional. Nuk

mund të ndodhë që ata të thonë diçka që është e papranueshme nga na logjike. Ata mundin të thonë gjëra të pakapshme për arsyen njerëzore, por ato nuk janë të pamundshme.

Nga ajo çfarë thonë ata, mund të ketë diçka që është përtej aftësisë së disa njerëzve për të kuptuar dhe për të përfytyruar, meqë njerëzit dallojnë në aftësinë për të arsjetuar. Në lavdinë, në sundimin, në shenjat dhe në krijimin e Zotit ka gjëra që njerëzit – shumë prej tyre – nuk mundin t'i kuptojnë apo t'i përfytyrojnë.

Mjafton për ty të dish se Musa عليه السلام, pavarësisht pozitës që kishte, kur Zoti nisi t'i shfaqej malit, e thërrmoi atë dhe Musës عليه السلام i ra të fikët, pas çka ai tha:

'Lavdi të qoftë Ty! Të kthehem i penduar dhe jam i pari që besoj.' (el-A'rafë, 143)

Shumë njerëz, duke u bazuar në arsyetimin e vetë, mendojnë se ka gjëra të pamundshme ndërsa ato janë të mundshme, dhe mendojnë se ka gjëra të mundshme apo të domosdoshme ndërsa nuk është kështu." (*Bejaan Telbis el-Xhehemijeh, 5/534*)

Hapi i parë që njeriu duhet të marrë në shtegun e Islamit apo të dorëzimit ndaj Zotit të botëve është që t'i dorëzohet Atij me mish e me shpirt, pa e kundërshtuar në sundimin, fuqinë dhe punët e Tij. Njeriu i dorëzohet hyjesisë së Tij duke iu nënshtruar vendimeve të Tij dhe duke pranuar urdhrat e Tij. S'ke si të pranosh përkatësinë e një njeriu ndaj Islamit, nëse ai nuk dorëzohet krejtësisht - në çdo çështje, e vogël a e madhe qoftë – Zotit të botëve dhe të pranojë ligjet e Tij dhe fenë e Tij, edhe nëse ajo nuk përputhet me tekat dhe dëshirat e tij. Allahu ﷻ thotë:

"Por jo, pasha Zotin tënd, ata s'do të kenë besim, derisa të bëjnë ty (O Muhamed) gjykatës në të gjitha mospajtimet që kanë mes vete, të mos gjejnë në vetët e tyre kundërshtim ndaj vendimeve tua dhe t'i pranojnë ato më një nënshtrim të plotë." (en-Nisa, 65)

Allahu ﷻ nuk të lë të zgjedhësh, kur ke të bësh me ndonjë çështje të fesë; domethënë që të besosh në një pjesë të saj, nëse ajo ka kuptim për ty ose të përshtatet, apo të shpikësh një ligj a sistem tjetër fetar, nëse ndodh të të mos pëlqejë ndonjë gjë nga feja Islame. Allahu ﷻ s'ka kurrfarë nevojë për ndonjë ortak në atë çfarë bën. Allahu ﷻ thotë:

"Ata (hipokritët) thonë 'Besuam në Allahun dhe në të Dërguarin (Muhamed) dhe bindemi,' pastaj një pjesë prej tyre kthejnë shpinën. Të këtillët janë mosbesimtarë. Kur ata thirren për tek Allahu (te fjalët e Tij,

Kurani) dhe te i Dërguari i Tij për t'u gjykuar, një pjesë e tyre refuzojnë dhe kthejnë shpinën. Mirëpo, kur e vërteta është në anën e tyre, ata vijnë me vullnet dhe të nënshtruar. A kanë sëmundje në zemra? Apo dyshojnë dhe kanë frikë se mos Allahu dhe i Dërguari i tij po u bëjnë padrejtësi. Jo, por vetë ata janë zullumqarë (idhujtarë, hipokritë, keqbërës).

Thënia e vetëm e besimtarëve, kur thirren për tek Allahu dhe te i Dërguari i Tij për t'u gjykuar është: 'Dëgjojmë dhe bindemi'. Të këtillët janë të suksesshmit (që do të jenë në xhenet përgjithmonë). Ata që dëgjojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij duke iu frikuar Atij dhe duke kryer detyrat ndaj Tij, janë të suksesshmit.

Ata bëjnë be në Allahun se, sikur t'i urdhëroje, do të dilnin (për të luftuar në rrugë të Allahut). Thuaj: 'Mos bëni be. Kjo bindje juaja po dihet (të jetë e rreme). Vërtet Allahu di mjaft mirë çfarë bëni ju.'" (en-Nur, 47-52)

"Nuk i takon një besimtari – femër a mashkull qoftë – që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij të nxjerrin një vendim për ndonjë çështje, ai të bëjë zgjidhje tjetër. Kushdo që kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, devijon qartazi." (el-Ahzab, 36)

Et-Tahawi tha:

"Përkushtimi fetar s'mund të jetë i saktë, derisa njeriu të dorëzohet dhe të nënshtrohet. Kështu, kushdo që kërkon dije për atë që ka mbetur e fshehur për të dhe nuk kënaqet me dorëzim, aspirata e tij (për të ditur gjithçka) do ta parandalojë nga arritja e teuhidit (besimit) të pastër, nga dija e shëndoshë dhe nga besimi i duhur. I këtilli do të luhatet mes besimit dhe mosbesimit, mes pranimit dhe refuzimit; do të mbetet i kontrolluar nga dyshimet dhe i ngatërruar, duke mos besuar a mohuar ndonjë gjë realisht." (*Fi Metn et-Tahaawijjeh bi Ta'lik el-Albani*, 1/43)

Mospajtimi me çfarëdo që Allahu ﷻ ka shpallur dhe mospranimi i saj më mish e me shpirt, është ajo që çon njeriun në shkatërrim, ia heq besimin dhe ia anulon punët. Allahu ﷻ thotë:

"O ju që besoni, nëse i dilni në ndihmë Allahut (kauzës), Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndrueshëm. Por, ata që mohojnë (njësinë e Allahut), do të shkatërrohen dhe do t'u zhvlerësohen punët. Kjo sepse urreyen atë çfarë zbriti Allahu (Kuranin dhe ligjin islamik), kështu që Ai ua bëri punët të pavlefshme." (Muhamed, 7-9)

Ti duhet të përtërisht sinqerisht besimin tënd dhe Islamin tënd, në mënyrë që t'i dorëzohesh Zotit të botëve. Ti duhet të kujdesesh për zemrën tënde duke e pastruar nga ajo çfarë ka rënë në të nga mendimet e këqija dhe nga

dyshimet, dhe t'i kthehesh sërish Zotit të botëve. Vetë atëherë ti do të dish me siguri çfarë do të thotë të besosh dhe si duhet të jetë kjo.

Është përcjellë nga el-Abbas ibn Abdul-Mutalib se kishte dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të thoshte:

“Ka gjetur shijen e vërtetë të besimit ai, që është i kënaqur ta ketë Allahun për Zot, Islamin për fe, dhe Muhamedin për të Dërguar.” (Muslim, 39)

S’ka gjë që mund të të shpëtojë nga dhimbja e dyshimit, e pasigurisë, e ngurrimit dhe e ngatërimit më mirë sesa Libri i Allahut ﷻ. Lexo atë dhe mundohu ta kuptosh. Ngulmo në këtë duke reflektuar për kuptimet e tij, duke kërkuar udhëzim, prehje dhe siguri nga ai, siç thotë edhe Allahu ﷻ:

“Ata që nuk besojnë, thonë: ‘Përse të mos i zbret (Muhamedit) ndonjë shenjë nga Zoti i tij?’ Thuaj: ‘Vërtet Allahu e çorienton kë të dojë dhe orienton për tek vetja ata që i kthehen të penduar.’ Ata që besojnë dhe zemrat e tyre gjejnë prehje në kujtimin e Allahut – vërtet që në kujtimin e Allahut zemrat gjejnë prehje.” (e-Ra’d, 27-28)

Dëgjo këtë këshillë nga një njeri i dijshtëm dhe një filozof i urtë:

“Libri i Allahut ﷻ është mbrojtje dhe strehë. Në të ka shërim, sqarim, udhëzim dhe dritë. Në të gjendet përgjigja në çdo problem dhe atij i kthehet çdo i ngatërruar. Ajetet e tij që flasin në kuptim të përgjithshëm, mjaftojnë për njerëzit me zemra të shëndosha; ajetet e tij që flasin në kuptim më të veçantë, ofrojnë shërim të mjaftueshëm për njerëzit që kanë dyshime në zemrat e tyre. Kuptimet e tija të drejtpërdrejta do të të thërrasin t’i dorëzohesh asaj që është e fshehtë për ty; kuptimet e fshehta do të të udhëzojnë të pajtohesh me kuptimet e drejtpërdrejta. Kjo nëse ti kupton dallimin mes hyjnores dhe të qenët një rob. Por, nëse ti kontrollohesh nga dyshimet dhe ngatërimi, dhe s’mund të bësh dallimin mes të mirës dhe të keqes apo mes realitetit të vërtetë dhe realitetit të rremë, atëherë druaj se do të shkatërrohesh duke vazhduar të mbetesh i ngatërruar.” (*Besaa’ir wedh-Dhekhaa’ir* e et-Teuhîdi, 2/112-113)

Allahu ﷻ e di më së miri.